



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600764/2

Tiranë, \_\_. \_\_. 2016

**Lënda:** *Rekomandim për rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit A. B.*

**Drejtuar:** **Z. Arsim RAMA**  
**Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

**TIRANË**

*I nderuar z. Rama,*

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi **A. R.B.**, (*me nr. Libreze 141195*), i cili kërkon rishqyrtim si dhe rillogaritje të pensionit të pleqërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Konkretisht ankuesi pretendon se ka filluar punë në vitin 1965, kryesisht në nëntokë mbi 12 vjet. Sipas tij, ka punuar mbi 32 vjet dhe 3 vite ushtri të detyrueshme, në pozicione të vështira, duke paguar detyrimet për sigurimeve shoqërore e shëndetësore, deri në shkëputjen e marrëdhënieve financiare. Gjithashtu, ai pretendon se bazuar në vjetërsinë e punës dhe në pozicionet e vështira që ka patur, masa e pensionit që gëzon duhet të jetë më e lartë nga sa i është caktuar.

Për t'iu mundësuar rillogaritja e pensionit të pleqërisë, ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku thuhet se: "*Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

**REKOMANDOJMË:**

**Rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit A. R. B.**

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermir KAPEDANI**